



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 42, datë 23.09.2015

Për

“DHËNIEN E TITULLIT “SIMBOL I QYTETIT TË TIRANËS” AKTORIT PANDI TOÇE, QË HUMBI JETËN PAS NJË AKTI TË PASHSEMBULLT QYTETAR”

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenin 8/VII, gërma “a” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës, Nr.137, dt. 30.07.1999 “Për miratimin e titujve vlerësues të Bashkisë së Tiranës”

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për dhënie e titullit “Simbol i Qytetit të Tiranës” aktorit Pandi Toçe, që humbi jetën pas një akti të pashembullt qytetar.

Me motivacionin:

“Për aktin e pashembullt qytetar e humanitar duke u vetëflijuar për të shpëtuar nga mbytja një fëmijë, akt që qytetarët e Tiranës e vlerësuan si Simbol të Qytetarisë dhe Humanizmit”.

2. T’i akordojë familjes së të ndjerit shumën simbolike prej 500.000 lekë nga Bashkia e Tiranës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Promovimit të Qytetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI



BASHKIA E TIRANËS

Nr. prot. _____

Tiranë, më __/__/2015

Drejtuar: Z. Aldrin Dalipi

Kryetar

Këshilli Bashkiak i Tiranës

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

I nderuar Z. Dalipi,

Bashkëlidhur, ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim projekt – vendimin dhe relacionin: “Për dhënien e titullit Simbol i Qytetit të Tiranës Aktorit Pandi Toçe, që humbi jetën pas një akti të pashembullt qytetar”.

Ju urojmë punë të mbarë.

Me respekt

K R Y E T A R

ERION VELIAJ